

Tribunë publike në temë „Pasojat e martesave mes të miturve te popullata rome”

Më 19 qershor 2008 u mbajt tribunë publike në Dibër në temë “Pasojat e martesave mes të miturve te popullata rome”. Në tribunë morën pjesë 48 pjesëmarrës edhe atë: përfaqësues nga vetëqeverisja lokale dhe institucionet lokale (8), medime (4), organizata joqeveritare (12) dhe qytetarë dhe të rinj nga të gjithë bashkësitë etnike (24). Tribunën e udhëhoqi Nesime Salioska nga Organizata për afirmim multikulturor të Romëve “Roma SOS” nga Prilepi e cila bëri një prezantim të shkurtë për gjendjen e popullatë rome në Republikën e Maqedonisë duke theksuar se shkakun më i madh për largimin e fëmijëve rom nga shkollat për fat të keq është dukuria e shpeshtë e martesave mes të miturve.

Qëllimi i tribunës ishte të ngrihet vetëdija te popullata rome për pasojat që i sjell martesat mes të miturve nga aspekti ligjor, mjekësor dhe social, në këtë kontekst fjalim mbajtën bashkëbiseduesit në vijim: Rozita Bajrami (kryetare e Organizatës së Grave Rome nga Dibra), Ilir Iseni (avokat), Ismail Mersimovski (punonjës social i punësuar në Qendrën për çështje sociale në Dibër), Nuri Koleci (inspektor arsimit) dhe Edlira Piperku (specialist – gjinekolog).

Rozita Bajrami dërgoi mesazh deri te të gjithë të rinjtë Rom dhe prindërit e tyre që ta zgjedhin rrugën e drejtë dhe të vazhdojnë me arsimimin e vet për të qenë si të gjithë fëmijët tjerë në Dibër dhe mos ngecin mbas. Vetëm ashtu do të kenë një fëmijëri pa brengë, të lumtur dhe të gëzuar, e jo të jenë si njerëz të rritur para kohe. Ilir Iseni i njoftoi të pranishmit me ligjin me të cilin rregullohet martesat, dokumentet e duhura për martesë, ndarje, alimentacion dhe pasojat ligjore në rast të mosrespektimit të Ligjit për shkollim të mesëm të detyrueshëm. Ismail Mersimovski dha një pasqyrë për gjendjen me martesat mes të miturve në Dibër dhe rrethinë, kushtet e vënies së marrëdhënieve martesore dhe shkaqet për atë (niveli i ulët i kulturës dhe niveli i ulët i arsimit mes prindërve, varfëria, papunësia, jobarazia gjinore, doket tradicionale dhe religjioze dhe paragjykimet, përvoja e hershme seksuale e të rinjve dhe shtatzënia e paplanifikuar). Nuri Koleci e përmbylli pjesën për sfidat shoqërore duke theksuar se vetëm me arsimim kualitativ mundet të pengohen martesat e hershme të padëshiruara. Edlira Piperku foli për gjendjen me lindjet e parakohshme në botë, pasojat shëndetësore dhe statistikisht. Ajo theksoi se nga kjo tribunë duhet të del se baza e secilës familje është nëna, nëse ajo është e mitur, e pa arsimuar dhe nuk din ti edukon fëmijët, familja dhe fëmijët nuk do të kenë të ardhme dhe do të përsëritet e njëjta situatë. Prandaj ky zinxhir duhet të ndërpritet.

Pastaj në diskutim u kyçën edhe pjesëmarrësit. U debatua për trekëndëshin nxënës-prind-mësues, arsimimi i prindërve, respektimi i ligjeve, përgjegjësia e mjekëve që kryejnë abortime të vajzave të mitura në ordianca jolegale, të drejtat e fëmijëve, dhuna familjare, etj. U konstatua se paraqitja e martesave mes të miturve është e pranishme edhe te bashkësitë tjera etnike, por më masovike është te popullata rome, posaçërisht në mjediset rurale. Si shkaqe më të shpeshta për këtë dukuri u cekën problemet ekonomike dhe niveli i ulët i arsimit. Në tribunë u shfaqën shpresa se ligji i ri i cili parasheh paket plotësues social për shkollimin e çdo fëmije nga familjet sociale do të ndihmon në rritjen e numrit të rinjve të shkolluar e me këtë edhe në zvogëlimin e martesave mes të miturve. Tribunën e organizoi Fondacioni Instituti Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrën lokale të projektit në Dibër (Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë – Dibër, ish Qendra për përkrahjen e OJQ-ve). Në qershor të vitit 2008 u organizua tribunë në të njëjtën temë edhe në Dellçevë.